Kronikë

Tiranë/ Shpërthimi te Noteria në ish-Bllok ishte porositur! 3 në pranga, 2 në kërkim! Po punohet për të zbuluar porositësin

Policia e shtetit zbardh dhe shpëthimin e ndodhur tek noteria në zonën e Ish Bllokut dhe arreston autorët. Drejtori i policisë thotë se kemi të bëjmë me një krim të kryer me pagesë.

■ VIDEO/ Shikoni dëmet e shkaktuara nga shpërthimi tek zyra noteriale

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
5 Shkurt, 11:15 | Përditesimi: 5 Shkurt, 12:27

Share

Zbardhen autorët e tritolvënies në zyrën e noterisë **në pronësi të Esmeralda Dautit** ndodhur më 30 janar 2024 në rrugën "Perlat Rexhepi", në zonën e ish bllokut në Tiranë. Shpërthimi i ndodhur në orën 04:10 minuta të mëngjesit të asaj dite shkaktoi dëme materiale jo vetëm noterisë por dhe bizneseve ngjitur.

Gjashtë ditë më pas drejtori i policisë së Tiranës Tonin Vocaj doli sot në një konferencë për median për të informuar se dje (4 shkurt 2024) u arrestuan 3 autorë, ndërsa u shpallën në 2 bashkëpunëtorë të tyre.

Të arrestuar janë
Real Zefi, 33 vjeç, banues në Shkodër
Korrado Katana, 33 vjeç, banues në Durrës
Eno Flamuraj, 36 vjeç, banues në Korçë.

Gjithashtu u shpallën ne kërkim 2 shtetas.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Mbillen pemë pranë shkollës 'Sevasti Qirjazi', Veliaj: Park i vogël për komunitetin e zonës! Nismës i bashkohet edhe Çiljeta Xhilaga

Arrestimi i tyre u krye nga strukturat hetimore të Komisariatit të Policisë Nr. 2, në kuadër të operacionit të koduar "Porosia". Para gazetarëve drejtori Vocaj informoi se ngjarja është dokumentuar me prova ligjore dhe zbulon si kanë vepruar.

> *"Shtetasit e mësipërm, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, më datë 30.01.2024, kanë vendosur sasi lënde plasëse në një zyrë noteriale dhe pas ngjarjes, autorët kanë lëvizur me motomjetin e shtetasit Eno Flamuraj. Më pas, motomjetin e kanë braktisur në liqenin e Farkës dhe pas kësaj janë larguar me automjetin tip "Audi", të shtetasit Korrado Katana" u shpreh Vocaj*

Bëhet fjalë për një krim me pagesë

> *"Nga hetimi i deritanishëm dhe analiza e autorëve ka rezultuar se kanë kryer këtë kundrejt pagesës vijon puna hetimore për të evidentuar porositës" tha drejtori i policisë Tonin Vocaj.*

Nga pamjet e Report Tv të asaj dite shiheshin dëmet e shkaktuara nga shpërthimi. Ndërkohë, dëme ka pësuar edhe një makinë që ka qenë e parkuar aty pranë.

S.G/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | esmeralda dauti | shperthim tritoli | Real Zefi | Korrado Katana | Eno Flamura

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Reforma zgjedhore, a duhet të votohet me lista të hapura?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Goditet grupi kriminal nga Kosova, trafikonte eksploziv në Shqipëri! 3 në pranga, 2 në kërkim! 203 kallëpë TNT ishin fshehur në kuti lëngjesh (EMRAT)
5 Shkurt, 11:04

VIDEO/ Shkodër, 12 orë të bllokuar në malin e Bogës, shpëtohen 3 alpinistët nga Tirana! Njëri i dëmtuar në këmbë
5 Shkurt, 08:15

Tirana kundër FSHF-së: Këta arbitra po tallen me stemën tonë, e papranushme
4 Shkurt, 20:32

Vijon tradita, Policia Bashkiake e Tiranës dhuron gjak
4 Shkurt, 18:53

I shpallur në kërkim për prodhim dhe trafik droge, arrestohet 36 vjeçari në Tiranë
4 Shkurt, 10:58



EMRI/ Lëvizte me pistoletë në Tiranë, arrestohet 22 vjeçari, dyshohet se kishte në plan ta shistel Pas kontrollit në banesë i gjenden edhe fara kanabisi (VIDEO)
4 Shkurt, 10:02

Tiranë/ Policia rrugore bën bilancin e një jave: 19 shoferë të arrestuar dhe mbi 9600 gjoba për shkeljen e rregullave të qarkullimit
4 Shkurt, 09:36

Nga Big Basta me djalin e tij te Luiza Gega, personazhet e njohur i bashkohen fushatës për mbjelljen e pemëve në Tiranë
4 Shkurt, 09:24

Dritan Mehmeti kërkon kujdes ndaj Erzenit: Dinamo ndjen presionin e rezultatit
3 Shkurt, 22:45

Tiranë/ Makina me shpejtësi përplaset me karrotrecin, katër të rinj të plagosur! Foto nga aksidenti
3 Shkurt, 20:25

Kori i Filarmonisë së Kosovës nis festën e Pavarësisë në Tiranë! Artistët këndojnë pjesë shqiptare, befasojnë publikun
3 Shkurt, 17:03

Në kërkim ndërkombëtar, mashtruesi Florian Gjergji merret i pandehur! U zhvaste para biznesmenëve duke u hequr si zyrtar

Sokol Dema

3 Shkurt, 13:21

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje